



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 276

Tiranë – E mërkurë, 24 maj 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 225, datë 11.5.2016	
Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” .....	27831



## UDHËZIM

Nr. 225, datë 11.5.2016

**PËR PROCEDURAT E PEZULLIMIT NGA LISTA E ZGJEDHËSVE PËR SHTETASIT QË VUAJNË DËNIMIN E PARASHIKUAR NGA LIGJI NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 12, të ligjit Nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

## UDHËZOJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e udhëzimit, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve listën e plotë të shtetasve, të cilët vuajnë aktualisht dënimin për kryerjen e një prej veprave penale të parashikuara nga gerrat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

2. Sasia e informacionit që kërkohet, mbliidhet dhe ruhet për shtetasit e përmendur në pikën 1 të këtij udhëzimi, vetëm për efekt të realizimit të këtij detyrimi ligjor, hartohet në format elektronik dhe të printuar sipas tabelës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për zbatimin e procedurës për pezullimin e shtetasve nga lista e zgjedhësve, të cilët parashikohen nga gerrat “a” dhe “b” të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, cakton personin përgjegjës/nëpunësin përgjegjës, brenda drejtorisë së përgjithshme, i cili do të kryejë këtë proces, përveç detyrave të tjera funksionale të përcaktuara në përshkrimin e punës.

4. Nëpunësi i ngarkuar hap dosje të veçantë dhe krijon bazën e të dhënave për këtë proces.

5. Nëpunësi i ngarkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, verifikon në RKGJC të dhënat e shtetasve të përfshirë në listën

e ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për shtetasit që vuajnë aktualisht dënimin, duke i ndarë sipas zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin aktual secili prej tyre.

6. Nëpunësi i ngarkuar, pas verifikimit në RKGJC, në rast mospërputhje të të dhënave, vepron sipas rastit:

a) kur konstaton se ka gabime, të cilat nuk krijojnë dyshime për identitetin e shtetasit, korrigjon tabelën me listën emërore të këtyre shtetasve,

b) kur konstaton se ka mospërputhje, ku vihet në dyshim identiteti i shtetasit, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve informacion shtesë, deri në përcaktimin e identitetit të saktë.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, çdo vendim apo informacion që vjen nga gjykata e rrethit gjyqësor, me objekt gjykimi sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, ia përcjell nëpunësit të ngarkuar për këtë qëllim.

8. Nëpunësi i ngarkuar, pas marrjes së materialeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryen fillimisht verifikimin dhe krahasimin e të dhënave personale në RKGJC, për shtetasit e përfshirë në listë, sipas pikave 5 dhe 6 të këtij udhëzimi.

9. Çdo vendim i gjykatave të rretheve gjyqësore, me objekt gjykimi sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, i cili depozitohet pranë DPGJC, me qëllim përlllogaritjen e afatit të përfundimit të dënimit të personit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, informacionin për kohën e përfundimit të dënimit të shtetasit objekt gjykimi. E njëjta procedurë kryhet edhe për rastet e vendimeve të gjykatave të apelit.

10. Kërkesa, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, shoqërohet me tabelën e përgatitur nga DPGJC, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi dhe me kopje të vendimit të gjykatës.

11. Përgjigjja e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve verifikohet me të dhënat e krijuara nga nëpunësi i ngarkuar dhe pas verifikimit, lista emërore e hartuar sipas vendbanimit të shtetasve, i dërgohet menjëherë në formë shkresore zyrave të gjendjes civile përkatëse.

12. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, menjëherë, pas marrjes së informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryen veprimet për pezullimin nga lista e zgjedhësve të



këtyre shtetasve, sipas procedurës së paraqitur në manualin, bashkëlidhur këtij udhëzimi në shtojcën nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e tij.

13. Pas kryerjes së veprimeve sipas manualit bashkëlidhur, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile që ka kryer veprimin, dërgon njoftimin në DPGJC, në lidhje me pezullimin e shtetasit nga lista e zgjedhësve.

14. Nëpunësi i ngarkuar nga Drejtori i Përgjithshëm, verifikon çdo njoftim të ardhur nga zyrat e gjendjes civile, në lidhje me zbatimin e procedurës së pezullimit nga lista e zgjedhësve.

15. Pas verifikimit për zbatimin e procedurës, Drejtori i Përgjithshëm, harton njoftimin për shtetasin përkatës në lidhje me ekzekutimin e kësaj mase si pasojë e vendimit të gjykatës dhe ia dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

16. Nëpunësi i ngarkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, gjatë periudhës para zgjedhore, kontrollon çdo ekstrakt të listave të zgjedhësve, deri në hartimin e listës përfundimtare.

Kur vëren se në ekstrakt ka ende shtetas të cilët nuk duhet të jenë të përfshirë, bën me dije nëpunësin e zyrës së gjendjes civile përkatëse për krerërit e veprimeve. Njëkohësisht për çdo rast bën me dije dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

17. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, me kërkesë të interesuarit pas përfundimit të dënimit, por dhe me iniciativën e tij, pasi verifikon përfundimin e afatit ligjor, sipas listës së ardhur nga DPGJC, të pezullimit të emrit në listën e zgjedhësve, aktivizon atë sipas procedurës përkatëse, parashikuar në aktet e tjera për këtë qëllim.

18. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME  
**Saimir Tahiri**



MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME  
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

### SHTOJCA NR. 1

## Manuali për procedurën e pezullimit nga lista e zgjedhësve të shtetasve

Për realizimin e pezullimit të shtetasve nga lista e zgjedhësve në kuadër të ligjit Nr. 138/2015, së pari duhet të ndryshohet numri i qendrës së votimit nga ai aktual. Numri i ri që do të përdoret është 7788. Ky veprim bën të mundur që shtetasi nuk do të shfaqet në listat e zgjedhësve. Ai do të shfaqet në një listë të veçantë dhe pas kësaj njoftohet i interesuari. Nëpunësi do të kryejë këto veprime në RKGJC.

#### 1. Kërkimi i Personit :

WCC Assist  
Gjendja e veçantë

Mjedis tes

Procesi i regjistrimit  
Kërko person  
Krijo person

Kërko person  
Informacion  
Pajtim i gjel  
Akses | Kërko

Të dhëna personale

Emri: Aaaa  
Mbiemri: Bbbba  
Datëlindja  
Etnia/Cyber i lindjes  
Shërbësia: Zgjidh  
Seksi: Mashkull | Femer  
Rreth: Zgjidh  
Vendi: Zgjidh  
Rrugë  
Numri i adresës  
Hytë  
Numri i banesës opt  
Kodi postar



Adresë

Printo certifikatën historike  
Raportim

Akti i lindjes  
Akti i ndërrimit  
Akti i martesës  
Administrimi i qendrës së votimit  
Parametri

Numri i dokumentit të identitetit  
Lloji i dokumentit: Zgjidh

Plotësohen të dhënat dhe klikohet te butoni "Kërko"



- Aktivizimi i personit në listën e zgjedhësve kryhet duke plotësuar numrin e votimit të zgjedhësit me numrin e qendrës së votimit ku i takon të votojë, sipas procedurës standarte.

**- FUND -**

Faqe: 3 - Procedurat e pezullimit të shtetasve nga lista e zgjedhësve dhe njohësimin e tyre në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 32 lekë